

Nr. 6 Prot., dorej 11. 01. 2014



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË  
MINISTRIA E ENERGJISË  
DHE INDUSTRISË

Nr. 788/  
Prot.

Tiranë, më 30/12/2016

URDHËR

Nr. 454/Datë 30/12/2016

PËR

MIRATIMIN E RREGULLORES SË GRUPIT NDËRINSTITUCIONAL TË PUNËS  
(MSG), NË KUADER TË ANËTARËSIMIT NË ORGANIZMIN NDËRKOMBËTAR  
EITI INTERNATIONAL

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, nenit 12 të VKM Nr.993 datë 09.12.2015 “Për organizimin dhe funksionimin e Sekretariatit Kombëtar të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse në kuadër të anëtarësimit në Organizimin Ndërkombëtar EITI International”, si dhe të pikës 5 të Urdhrit të Kryeministrit Nr.71, datë 20.01.2011 “Për ngritjen dhe funksionimin e Grupit Ndërinstitucional të Punës (MSG), në kuadër të anëtarësimit në organizmin ndërkombëtar EITI International”, Ministri i Energjisë dhe Industrisë pasi u njoh me Rregulloren e Grupit Ndërinstitucional të Punës (MSG) të ngarkuar me zbatimin e EITI-it në Shqipëri, me propozim të Sekretariatit për Nismën për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI-Shqipëri),

URDHËROJ:

1. Miratimin e Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Grupit Ndërinstitucional të Punës (MSG), në kuadër të anëtarësimit në organizmin ndërkombëtar EITI International”.
2. Ngarkohet Kryetari i Grupit Ndërinstitucional të Punës për marjen e masave për sigurimin e zbatimit të Rregullores nga anëtarët e grupit.
3. Urdhri Nr. 21, datë 20.01.2012 “Për miratimin e Rregullores për organizimin dhe funksionimin e Grupit Ndërinstitucional të Punës për Ndjekjen e Procedurave të Anëtarësimit të Shqipërisë në Nismën për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse”, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.



## RREGULLORE

### PËR

# ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E GRUPIT NDËRINSTITUCIONAL TË PUNËS (MSG) NË KUADËR TË ANËTARËSIMIT NË ORGANIZMIN NDËRKOMBËTAR EITI- INTERNATIONAL

#### Hyrje

Nisma për Transparencën në industritë Nxjerrëse - EITI (këtej e tutje EITI<sup>1</sup>) është një iniciativë ndërkombëtare që ka në objekt të saj të zhvillojë dhe implementojë një mekanizëm për të bërë deklarimin e të ardhurave që vilen nga përdorimi i Burimeve Natyrore nëpërmjet Industriive Nxjerrëse, publikimin e këtyre të dhënave në një format të kuptueshëm nga të gjithë dhe mbikqyrjen e tyre në mënyrë që ti mundësojë publikut të gjerë të ketë informacion përsë i përket të ardhurave si dhe shpenzimeve publike, duke kontribuar kështu në një debat publik dhe krijimin e mekanizmave për mirëadministrim e këtyre të ardhurave në dobi të komuniteteve.

Proçesi i EITI-t mund të dimensionohet më tej dhe të përshtatet sipas kontekstit aktual të çdo vendi zbatues, për të përbushur nevojat informative të palëve të interesuara si dhe nevojat për të prekur sektorin me reforma të rëndësishme bazuar në këto të dhëna.

Sic përcaktohet në Kërkesat e Standartit EITI, Implementimi i Standartit EITI kërkon mbikëqyrje efektive të procesit EITI nga të gjitha grupet e interesit. Kjo realizohet nëpërmjet krijimit dhe funksionimit të një Grupi me Shumë Aktorë (këtej e tutje MSG<sup>2</sup>), në të cilin përfshihen përfaqësues të qeverisë, kompanieve që operojnë në këtë sektor dhe pjesëmarrjes së plotë, të pavarur, aktive dhe efektive të shoqërisë civile, të cilët angazhohen të punojnë sëbashku për të zhvilluar e promovuar transparencën dhe mirëqeverisjen e këtij sektori.

Në kushtet e reja dhe me ndryshimin e Standartit EITI është i nevojshëm rishikimi i Rregullores së mëparshme.

#### Objektivi dhe Misioni i EITI-t në Shqipëri

Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 993 "Organizimin dhe funksionimin e Sekretariatit Kombëtar të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI-Shqipëri), në kuadër të antarësimit në Organizmin Ndërkombëtar EITI- International" dhe përpjekjet për institucionalizimin dhe zbatimin e reformave në sektorin e industrisë nxjerrëse të Shqipërisë, tregon seriozitetin e qeverisë shqiptare për të siguruar se industriët nxjerrëse në Shqipëri i shërbejnë të mirës madhore të popullit Shqiptar. Transparenca më e madhe në të ardhurat që vilen nga këto industri dhe njohja e duhur e këtyre

<sup>1</sup> EITI që qëndron për "Extractive Industries Transparency Initiative"

<sup>2</sup> MSG qëndron për "Multi Stakeholder Group" ose në shqip, "Grupi me Shumë Aktorë"

pagesave nga ana e qeverisë në të gjitha nivelet, është kusht themelor për mirëqeverisjen e këtyre burimeve natyrore për të mirën e vendit dhe qytetarëve të tij.

#### Neni 1

##### Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Grupit me Shumë Aktorë, ose Grupit Ndërinstitucional të Punës (MSG) të formuar për të drejtuar dhe mbështetur Implementimin e Nismës për Transparency në Industrinë Nxjerrëse (EITI) në Shqipëri. Kërkesat për vëndet zbatuese janë përcaktuar në Standartin EITI 2016. Informacion shtesë gjendet në: [www.eiti.org](http://www.eiti.org) (<http://eiti.org/document/standard>)

#### Neni 2

##### Objekti

Kjo rregullore përcakton rregullat dhe procedurat lidhur me:

- a) Organizimin dhe funksionimin e mbledhjeve të Grupit Ndërinstitucional të Punës ose Multi Stakeholder Group (MSG), në kuadër të anëtarësimit në organizmin ndërkombëtar EITI International të Shqipërisë në “Nismën për Transparency në Industrinë Nxjerrëse (EITI), më poshtë MSG”.
- b) Përgatitjen, paraqitjen, shqyrtimin dhe marrjen e vendimeve nga MSG.

#### Neni 3

##### Përkufizime

Për qëllime të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

- a) “MSG” është një komitet i nivelit të lartë me detyrën për të ndërtuar politika/vendime apo bërë komente për politikat dhe për vendimet të cilat pritet të prekin të gjithë grupet e interesit.
- b) “EITI Shqipëri” është Sekretariati Kombëtar për Transparency në Industrinë Nxjerrëse (më poshtë referohet EITI).

#### Neni 4

##### Roli, përgjegjësitet dhe të drejtat e MSG (Standarti EITI 2016 1.4/b)

1. MSG-ja duhet të funksionojë si një komitet i nivelit të lartë me detyrën për të ndërtuar politika/vendime apo bërë komente për politikat dhe për vendimet të cilat pritet të prekin të gjithë grupet e interesit. Si rrjedhim MSG-ja duhet të përfshijë anëtarë me reputacion

dhe që janë të njojur gjerësish si përfaqësues/ anëtarë të grupeve përkatëse të interesit (përfshirë këtu përfaqësuesit e e Qeverisë apo Agjencive Shëtërore, Operatorëve të sektorit dhe Organizatave të Shoqërisë Civile) me kapacitetin që të veprojnë në emër të tyre.

2. MSG duhet të ndërmarrë aktivitete efektive komunikimi dhe të përhapë veprimtarinë e same grupime të shoqërisë civile dhe kompanitë operatore, nëpërmjet mënyrave të ndryshme: Komunikimeve të drejtëpërdrejta apo komunikimeve me shkrim, Mediave, Websiteve, duke informuar palët e interesit për veprimtarinë e qeverisë dhe rolin qëndror që ka në këtë proces shoqëria civile dhe operatorët e industrisë nxjerrëse, dhe për të grumbulluar e sjellë në MSG zërin e palëve të interesuara. MSG duhet gjithashtu të shpërndajë gjerësish informacionin publik që prodhohet nga proceset EITI si dhe Raporti EITI-t.
3. Anëtarët e MSG-së duhet të ndërlidhen në mënyrë konstante në këtë proces me grupimet që përfaqësojnë.

#### Neni 5

#### Objektivat dhe veprimtaria e MSG

Në përbushje të detyrimeve ligjore, objektivat e veprimtarisë së MSG-së janë:

- a) Të përcaktojë objektivat e procesit EITI në Shqipëri;
- b) Të punojë për hartimin e politikave dhe drejtimit strategjik të nevojshëm për implementimin me efektivitet të iniciativës në Shqipëri;
- c) Të evidentojë/ vlerësojë pengesat që hasen në këtë proces dhe të punojë për eliminimin e tyre;
- d) Të punojë për të mbajtur të qëndrueshëm angazhimin politik për iniciativën dhe mobilizimin e burimeve për të mbështetur aktivitetet dhe qëllimet e saj;
- e) Të sigurojë që iniciativa është integruar në mënyrë efektive në procesin e reformave të paraqitura nga ana e qeverisë dhe në axhendën e çdo reforme qeveritare që lidhet me të.
- f) MSG-ja të përfshihet dhe të bëhet pjesë e konsultimeve prej strukturave për kuadrin ligjor (akte ligjore nënligjore) që kanë të bëjnë me EITI-n.

#### Neni 6

#### Parime të përgjithshme

Angazhimi mes anëtarve të qeverisë, biznesit dhe shoqërisë civile në MSG, do të bazohet në parimet e mëposhtme:

- **Interesin Kombëtar** - të mbështesin të gjitha proceset EITI para interesave të organizatave apo individëve të veçantë dhe për transparencën e plotë të institucioneve publike dhe private;
- **Integritetin** – Çdo anëtar i MSG apo grup interesi duhet të mbështetet në standarde morale dhe profesionale për përbushjen e angazhimeve;

- **Përfshirjen** – Çdo palë interes ka të drejtën që të zgjedhin lirisht përfaqësuesit e tyre, duke pasur parasysh nevojën për pluralizëm dhe diversitet. Ftesa për të marrë pjesë në MSG duhet të bëhet në mënyrë të hapur dhe transparente;
- **Angazhimin e plotë dhe dialogun gjithëpërfshirës** – të krijojnë një mjedis ku të gjithë pjesëmarrësit mund të angazhojen lirisht dhe në mënyrë të hapur;
- **Transparencën** – t'u sigurojë të gjitha palëve të përfshira në proces si dhe publikut të gjërë, akeses në të dhëna dhe informacion të saktë, në varësi të kushteve të parashikuara në ligj;
- **Përgjegjshmërinë** – ti përbahet rregullave, standardeve dhe udhëzimeve të angazhimit në MSG, dhe të përmbushë rolin e saj;
- **Partneritetin** – të bashkëpunojnë, të ndajnë përgjegjësitë dhe të mbështhesin respektin e ndërsjellë për të siguruar arritjen e objektivave;
- **Konsultimin, Ngritjen e Kapaciteteve dhe Fuqizimin** – të punojnë për rritjen e vazhdueshme të njojurive mbi sektorin, praktikat më të mira botërore dhe për shkëmbimin e njojurive nëpërmjet dialogut të vazhdueshëm;
- **Respektimin e Proceseve të Brendshme** - të kuptojnë dhe të veprojnë në përputhje me kufizimet e palëve të interesuara, me respekt ndaj natyrës së informacionit që do të publikohet dhe shkallën e përfshirjes në këtë proces bazuar në kufizimet institucionale/ të vendosura me ligj;
- **Qëndrueshmërinë** - të sigurojnë angazhim të vazhdueshëm, duke zyrtarizuar politika progresive dhe mekanizma operacionale që do të promovojnë një mjedis besimi të ndërsjellë;

## Neni 7

### Përbërja e MSG

MSG-ja shqiptare ka në përbërjen e saj përfaqësues të:

- Institucioneve qeveritare palë në procesin EITI;
- Kompanive që operojnë në sektorin e Industrive Njerrëse dhe;
- Shoqërisë Civile Shqiptare e cila në vetvete mund të përfaqësohet në MSG nëpërmjet Grupimeve të Pavarura e me bazë të gjerë të shoqërisë civile, përfaqësuesve të mediave, botës akademike apo sindikatave.

MSG-ja do të ketë formatin e mëposhtëm:

- Kryesoheret nga Zëvëndësministri i Energjisë dhe Industrisë dhe në përbërje do të ketë këta anëtarë:
- 7 (shtatë) Përfaqësues të Institucioneve dhe Agjencive Shtetërore të përfshira në proceset EITI; Niveli i përfaqësimit në këtë grup për institucionet shtetërore do të jetë jo më i ulët se Drejtor Drejtoria.
  - Një përfaqësues nga Ministria e Energjisë dhe e Industrisë;
  - Një përfaqësues nga Ministria e Financave;
  - Një Përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë;
  - Një Përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;

- Një Përfaqësues nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore;
  - Një Përfaqësues nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar;
- c) 5 (pesë) përfaqësues nga biznesi të përzgjedhur nga kompanitë më të mëdha operuese në vend në Sektorin e Industrisë Nxjerrëse dhe në Hidroenergji, si dhe Shoqatave të Investorëve në këtë sektor apo Dhomave të Tregëtisë me fokus në burimet natyrore;
- d) 5 (pesë) Përfaqësues nga shoqëria civile, të përzgjedhur nga Grupime Kombëtare të Shoqërisë Civile, Gazetarë, figura të shquara akademike, Grupime të pavarura eksperësesh të sektorit (thinktanks) si dñe grupime të sindikatave, me shtrirje të gjërë gjeografike. Proçesi i përzgjedhjes për përfaqësuesit e OSCHC-ve në MSG përcaktohet bazuar në proçesin zgjedhor të pëershkuar në "Kodin e Sjelljes së OSHC-ve të përfshira në proçesin EITI" (për informacion kodi i plotë është bashkëngjitur si Aneks kësaj Rregullloreje);

#### Neni 8

#### Detyrat funksionale të MSG

Detyrat funksionale të MSG-së janë:

- a) Të sigurojnë angazhimin e aktorëve të ndryshëm në implementimin e EITI-t;.
- b) Duke u konsultuar me aktorët kryesorë EITI-t, të përgatisë dhe të publikojë një plan punë të plotë me kosto të përllogaritur (Standarti EITI 1.5);
- c) Të mbikëqyrë implementimin e EITI-i dhe Planit të tij të Punës me qëllim arritjen e objektivave kombëtare;
- d) Të marrë pjesë në hartimin e Termave të Referencës për Administratorin e Pavarur në përputhje me strategjinë kombëtare, të marrë pjesë dhe të miratoje Raportet EITI si dhe Raportet Vjetore të aktiviteteve (Standarti EITI 1.4);
- e) Nëpërmjet anëtarëve të tij, të kryejë përhapjen e EITI-t në sektorë të ndryshëm në mbështetje të Planit të Punës;
- f) Të komunikojë dhe të ndërtojë ndërgjegjësimin në lidhje me EITI-n, objektivat e tij, përvojën dhe përsitimet e vendeve të tjera nga zbatimi i tij, si dhe progresin e implementimit të tij në Shqipëri; Çështjet që do të diskutohen në kuadër të MSG-së EITI Shqipëri do të kufizohen në ato që lidhen me EITI-n, përvèç rasteve kur me konsensus nga ana e MSG-së është rënë dakort ndryshe.
- g) MSG-ja bën vlerësimin e Planit të Punës dhe ndjek ekzekutimin e tij.

#### Neni 9

#### Roli i anëtarëve të MSG

Anëtarët e MSG duhet të veprojë me besnikëri, ndershmëri, integritet në të gjitha marrëdhëniet në emër të EITI-Albania dhe gjithmonë në interesin më të mirë të tij

##### **1. Roli i Përfaqësuesve të Oeverisë:**

- a) Të sigurojnë udhëheqje politike dhe mbështetje teknike për Sekretariatin dhe për EITI-n në Shqipëri;

- b) Të sigurojnë pjesëmarrjen e plotë të agjencive qeveritare kombëtare dhe njësive të qeverisjes vendore, në zbatimin e EITI-t dhe të krijojnë një mjeshtësi të përshtatshëm politikash për të;
- c) Të sigurojnë pjesëmarrjen e plotë të kompanive nxjerrëse;
- d) Të inkurajojnë pjesëmarrjen e plotë të shoqërisë civile;
- e) Të propozojnë një bazë ligjore për zbatimin e EITI-t, si dhe të identifikojnë dhe adresojnë barrierat ligjore dhe rregulloret që bllokojnë zbatimin e duhur të EITI-t;
- f) Të bëjnë publike të ardhurat e qeverisë dhe të dhënata përkatëse në mënyrë të sakië, në kohën e duhur dhe në një nivel të detajuar ashtu siç do të bihet dakord më parë nga MSG-ja;

### **2. Rol i Përfaqësuesve të Biznesit:**

- a) Të ndihmojnë për të siguruar pjesëmarrjen e plotë të kompanive nxjerrëse në implementimin e EITI-t në Shqipëri, në përputhje me detyrat e përcaktuara në Nenin 8 të Kodit të Sjelljes të OSCH-ve të përfshira në procesin EITI;
- b) Të bëjnë publike pagesat dhe të dhënata që lidhen me to për qeverinë dhe aktorë të tjera në mënyrë të saktë, në kohën e duhur dhe në një nivel të detajuar ashtu siç do të bihet dakord më parë nga MSG-ja;
- c) T'u komunikojnë grupeve të interesit të industrisë zhvillimet në EITI;

### **3. Rol i Përfaqësuesve të OSCH-ve:**

- a) Të komunikojnë dhe të konsultohen gjerësisht me grupe të ndryshme të palëve të interesit duke përfshirë edhe ato jashtë grupit drejtues dhe të ndërtojnë kapacitete për EITI-n;
- b) Të sigurojnë pjesëmarrjen e plotë të OSCH-ve përkatëse dhe palëve të tjera të përfaqësuara.
- c) Të monitorojnë publikimet e bëra nga kompanitë nxjerrëse dhe qeveria;
- d) Të konsultohen me grupimet e gjera dhe të propozojnë drejtime ku duhet të shtrihet veprimitaria e EITI-t në Shqipëri, përveç mandatit që rregullohet nga standarti EITI.

MSG-ja shqiptare nuk ka politikë për ndarjen e honorareve dhe dietave gjatë angazhimit në EITI. Angazhimi në MSG bëhet mbi baza tërësisht vullnetare.

### **Neni 10**

#### **Zgjedhja e përfaqësuesve të MSG**

Me qëllim ruajtjen e mendimit të diversifikuar dhe përfaqësimit të gjerë, çdo grup interesi ka të drejtën të përcaktojë përfaqësuesit e tij në MSG për EITI-n në Shqipëri. Proçesi i nominimit është i pavarur brenda secilit nëngrupim.

1. Kryetari i MSG-së i kërkon me shkrim Titullarit të çdo Institucionit të paraqesë përfaqësuesin e tij në MSG. Përfaqësuesit e Institucioneve Qeveritare të përmendura në pikën VII/b të këtyre ToR do i të emërohen nga titullarët e Institucioneve të tyre brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga marja e kërkesës. Përfaqësimi në MSG për këtë nëngrupim nuk është nominal, por lidhet me detyrën që mban personi i emëruar pranë Institutonit që përfaqëson;
2. Pjesëmarrja në MSG për përfaqësuesit e Shoqërisë Civile dhe përfaqësuesit e biznesit, me qëllim mundësimin e përfaqësimit me bazë të gjerë, bëhet me ftesë të hapur publike nga

Kryetari i këtij Grupi Pune dhe administrohet në mënyrë të pavarur dhe transparente nga secili grupim. Secili nga grupimet, duhet të bëjë transparente procedurën e përzgjedhjes së anëtarëve të MSG-së, dhe duhet të dokumentojë në mënyrë të plotë pranë Kryetarit të MSG-së, procesin dhe procedurën e përzgjedhjes dhe vlefshmérinë e mandatit të çdo anëtar;

3. Sekretariati EITI Albania do të ofrojë mbështetje teknike përgjatë procesit të përzgjedhjes në rast se kjo gjë kërkohet nga çdonjëri nga grupimet, për të përbushur transparencën e çdo procesi;
4. Sekretariati EITI Albania si përfaqësues i Shtetit Shqiptar që ka angazhimin zyrtar në procesin EITI, ka në çdo rast të drejtën të vëzhgojë procesin e zgjedhjeve të anëtarëve në MSG, nisur nga nevoja për të përbushur Interesin Kombëtar dhe të mirën e vendit si "Vend Zbatues EITI dhe ruajtjen e ketij statusi", para interesave të grupimeve apo individëve të veçantë dhe në kuadër të Transparencës së plotë të Iniciativës.

## Neni 11

### Mandati dhe zëvendësimi i anëtarëve të MSG

1. Antarët e grupeve të parë, emërimi i të cilëve është në varësi të pozicionit të punës që mbajnë në administratën shtetërore, nuk ruajnë në MSG një pozicion nominal por të lidhur me detyrën që kryejnë.
2. Çdo antar i MSG-së që përfaqëson në MSG shtetin shqiptar, duhet të sigurohet që të ketë një minimum prej 50% pjesëmarrje në mbledhjet e MSG-së, dhe 100% pjesëmarrje aktive në procesin EITI, në mënyrë që Institucioni të mbajë antarin e tij në MSG.
3. Antarët e dy grupeve të tjera të MSG-së, do të shërbejnë për një periudhë prej 3 vjetësh, pra mandati i plotë i tyre do të jetë 3 vjet, zëvendësimi i tyre do bëhet në mënyrë të përshkallëzuar në mënyrë që të sigurohet se do të ketë kujtesë institucionale mes tyre.
4. Nëse përfaqësuesit kanë pasur një performancë të mirë gjatë mandatit të tyre tre vjeçar ata mund të ri-emërohen nga përfaqësuesit e grupimit të tyre. Performanca e të gjithë anëtarëve do të matet nëpërmjet një vlerësimi vjetor që do të bëhet nga Kryetari i MSG-së me mbështetjen teknike të Sekretariatit Kombëtar EITI Shqipëri (ofrimi i listëprezencave të mbledhjeve, minutave të takimeve, prezantime, platforma apo materiale të ndryshme që mund të jenë të nevojshme e që masin kontributin real të çdo antari të MSG-së, etj.) çdo fillim viti. Performanca do të konsideroj cilësinë e pjesëmarrjes nëpërmjet implementimit të planit vjetor të punës. Ajo do matet në bazë të pjesëmarrjes të antarëve në mbledhje dhe kontributi që ata kanë dhënë në implementimin e EITI-t në Shqipëri.
  - a) 30% Pjesëmarrja në takime dhe në evenete mbështetëse që organizohen.
  - b) 30% Angazhimi në proceset konsultative dhe ndërtimin e politikave (komitet domethënëse në ToR, planifikimin e aktiviteteve vjetore, propozimin e ndërhyrjeve në politika, formulimin e tyre dokumentuar këto nëpërmjet minutave të takimeve, emaileve dhe korrespondencave sipas rastit).
  - c) 40% Angazhimi në proceset reale EITI (kontributi personal i dokumentuar në aktivitetet e komunikimit në terren dhe përhapjes së informacionit referuar standartit EITI (Standarti EITI pika 1.4)), në shërbim të implementimit të EITI-t, si dhe ideimi i nismave të reja.

5. Nëse në fund të procesit të vlerësimit përfaqësuesit kanë pasur një performancë më të ulët se 60%, do të kërkohet të zëvendësohen nga përfaqësuesit e grupimit të tyre duke ndjekur mekanizmat e veta të qeverisjes.

## Neni 12

### Konflikti i interesit

Anëtarëve të MSG u ndalohet përdorimi i pozitës së tyre të privilegjuar si anëtarë të MSG ose çdo informacion konfidencial i mbledhur në atë kapacitet për përfitime të tyre personale apo atë të ndonjë personi tjetër afér tyre.

Duke qenë se MSG-ja vendos për Planin e Punës EITI, vendos për projektet që do të zbatohen, strategjinë që duhet ndjekur dhe vlerëson zbatimin e tij, anëtarët e MSG-së nuk do të kenë të drejtën për të konkurruar për aktivitete në kuadër të kalendarit vjetor të EITI-t, as të jenë pjesë e grupeve të prokurimit, në mënyrë që të shbangjan konfliktet e interesit.

---

**Gjithashtu anëtarët e MSG-së nuk mund të pranojnë dhurata në lekë apo në çdo lloj forme tjetër nga persona që kanë lidhje në mënyrë të drejtëpërdrejtë apo indirekte me proceset EITI.**

## Neni 13

### Mbledhjet e MSG

MSG-ja mblidhet një herë në tre muaj ose aq shpesh sa është e nevojshme.

Kryetari do të thërrasë dhe të kryesojë mbledhjet e MSG-së, ndërsa njoftimet do të dërgohen nga Sekretariati Kombëtar EITI Shqipëri minimalisht një javë para datës së mbledhjes (mund të bëhen përjashtime kur për arsyet e ndryshme dërgimi i materialeve nuk mund të kap këtë limit kohor, gjithësesi antarëve të MSG-së do Ju lihet koha e nevojshme për konsultimin e materialeve para miratimit të tyre). Sekretariati gjithashtu do të merret me dokumentacionin dhe përgatitjen e procesverbaleve të mbledhjeve.

Minutat e takimeve do ti shpërndahen anëtarëve të MSG-së me anë të postës elektronike në momentin e parë që do zbardhen. Antarët do të kenë një javë kohë për të dërguar komentet e tyre dhe asnjë koment nuk do të konsiderohet i aprovuar pa konsensusin e shumicës. Minutat e takimeve dhe vendimet e marra nga MSG-ja do të publikohen nga Sekretariati dhe do të diskutohen në takimin e radhës së MSG-së.

Për çështje kur është e nevojshme një vendimmarrje por nuk është e nevojshme thërritja e një mbledhje, informacioni i nevojshëm do të shpërndahet përmes postës elektronike në mënyrë që vendimi të mund të merret në mënyrë elektronike, dhe me konsensus.

Në rastin kur një anëtar i MSG nuk paraqet komente/rekomandime nëpërmjet kësaj forme konsultimi, do të konsiderohet që është dakord me propozimin e paraqitur.

#### Neni 14

##### Vendimarrja e MSG

Vendimarrja në MSG do të synohet të arrihet në çdo rast me konsensus, në mirëbesim.

Në rastet kur nuk arrihet konsensus, do të proçedohet me votim.

Pesëdhjetë përqind (50%) e antarëve, me të paktën një përfaqësues nga qeveria, një nga shoqëria civile dhe një nga sektori i biznesit, tw cilwt do të përfaqësojnë kuorumin e Grupit Ndërinstitucional të Punës. MSG-ja, në mirëbesim, mund të marrë vendime me konsensus.

Ministria e Enerjisë dhe Industrisë si Ministri e linjës dhe e përcaktimit të politikave të sektorit, ka të drejtën të caktojë në mënyrë alternate përfaqësues të përhershëm në MSG nga Drejtoritë Hidrokarbure, Minerare, Hidroenergitike apo Ligjore, ku të drejtën e përfaqësimit (dhe të votës nëse paraqitet nevoja) e ka vetëm njëri nga katër alternatët, referuar çështjeve në diskutim dhe përcaktuar nga Kryetari i MSG-së.

Ankesat që mund të ketë çdonjëri do të trajtohen në mënyrë të hapur dhe bashkërisht përgjatë mbledhjeve të MSG-së.

#### Neni 15

##### Zbardhja dhe marrja fuqi e vendimeve të MSG

Zbardhja e vendimeve të MSG bëhet nga ana e Sekretariatit , brenda 5 (pesë) ditëve pune pas ditës së përfundimit të mbledhjes.Në rastet kur projekti nuk miratohet, MSG nuk merr vendim.

Vendimet e MSG zbardhen në dy kopje, njëra prej të cilave nënshkruhet nga Kryetari. Kopja tjetër nënshkruhet nga të gjithë anëtarët pjesëmarrës në mbledhje.

Vendimet e nënshkruara nga Kryetari i MSG depozitohen dhe regjistrohen në një libër të veçantë në zyrën e protokollit të MEI-it.

#### Neni 16

##### Dispozitat e fundit

Kjo rregullore merr fuqi dhe bëhet e detyrueshme për zbatim menjëhërë me miratimin e saj nga Ministri i Enerjisë dhe Industrisë.

## ANEKS: KODI I SJELLJES i Organizatave të shoqërisë civile të përfshira në procesin EITI.

### Përbajtja

Hyrje.....

.....1

Kapitulli I: Zgjedhja dhe mandati .....1

Kapitulli II: Përkufizimet e termave dñe parimet bazë..... 2

Kapitulli III: Të drejtat, detyrat që he detyrimet .....3

Pjesa 1: Zgjedhjet .....3

Pjesa 2: Fakte apo akte të dënueshëm.....4

Pjesa 3: Humhja e statusit, largimi dhe zëvendësimi .....4

Kapitulli IV: Komunikimi.....5

Kapitulli V: Dispozitat përfundimtare .....5

Kur Shqipërisë iu dha statusi i vendit anëtar në EITI në maj të vitit 2013, përfaqësuesit e grupit të Shoqërisë Civile në MSG punonin për zbatimin e standardeve të EITI, që transparenca të përkthehej në përgjegjshmëri si dhe pëtësigruar që të ardhurat nga burimet natyrore të përdoren në shërbim dhe përfitim të të gjithë qytetarëve.

Grupi i përfaqësuesve të shoqërisë civile ne MSG, mbështetur e zgjedhur nga Koalicioni i Organizatave të shoqërisë civile të përfshira në procesin e EITI-t, e sheh transparencën si mjet për të kërkuar përgjegjësi deklarimi nga të dy palët, kompanitë dhe qeveria. SHC në MSG do të jetë gjithmonë shumë aktive për të monitoruar dhe pëtësigruar se të ardhurat nga burimet natyrore shkojnë në shtet, të përfshihet ne kontrollin e shperndarjes së rentës dhe të sigurohet që ky proces kryhet me sukses. Si pjesë e rrjeteve të organizatave të shoqërisë civile që punojnë në Nismën për Transparencën e organizatave në gjithë botën, Koalicioni i Shoqërive Civile Shqiptare do ti referohet Strategjisë PËYP dhe Vizionit 20/20.

Ky kod i etikës synon të përmirësojë efikasitetin e pjesëmarries së të gjithë shoqërisë civile në proces, duke vendosur parametrat për përfaqësuesit e ShC në MSG për të punuar në kohezion e më gjërë së bashku me zonat mbështetëse, në mënyrë që njerëzit më të prekur nga aktiviteti industrish nxjerrëse, të kenë një zë në proces.

### **Kapitulli I Zgjedhja dhe Mandati**

#### **Pjesa I Zgjedhjet**

##### **Neni 1**

Çdo person, pjesëtar i një organizate të shoqërisë civile që aderon në këtë kod, mund të zgjidhet emërohet si përfaqësues i shoqërisë civile në MSG/Grupin shumë-palësh, pa paragjykuar dispozitat e nenit 2 të këtij kodit.

I tërë procesi zgjedhor duhet të jetë i drejtë, gjithëpërfshirës dhe transparent;

- a. Thirrjet për kandidatët dhe procesin e emërimit duhet të publikohen me kriteret kualifikuese nëpërmjet faqes on line të rrjetit, organizatave pjesëmarrese në rrjet dhe mjetet e tjera të informimit kur eshte e mundur, me qëllim; për të sigruar një pjesëmarje sa të gjerë.
- b. Bordi i Koalicionit të rrjetit bën procesin e shqyrtimit dhe përzgjedhjes të kandidatëve që nuk i përmbusin kriteret e përcaktuara.
- c. Shoqëria civile duhet të sigurohet për të mos lejuar asnjë ndërhyrje të qeverisë apo përfshirje në propozimin, emërimin dhe përzgjedhjen apo procesit zgjedhor.

#### **Neni 2**

Feriudha e Mandatit ië përsaqësuesit të shoqërisë civile në MSG është 3 vjet, e rinovueshme vetëm një herë në përputhje me nenin 6, pika 2 të këtij Kodi.

---

#### **Neni 3**

Zgjedhja është e organizuar sipas një procesi të drejtpërdrejtë me votim të të fshehtë. Ajo miratohet nga një raport zyrtar i nënshkruar nga të gjithë anëtarët e komisionit të posaçëm (anëtarëve të grupeve të Mbështetjes dhe 2 anëtarë MSG, të zgjedhur paraprakisht) dhe mbështetur nga lista e atyre që morën pjesë në zgjedhjet në fjalë.

Në rast kur duhet të zgjidhet vetëm një kandidat, dy kandidatët të cilët kanë marrë shumicën e votave duhet të shkojnë në një raund të dytë.

Zgjidhet kandidati që merr shumicën e përgjithshme të votave (50% +1).

#### **Neni 4**

Në rast të një barazimi, kandidatëve do t'ju kërkohet për të gjetur një konsensus; në të kundërt, organizohet raundi i dytë për të vendosur në mes të kandidatëve në përputhje me nenin 8 të këtij Kodi.

Në rast të një barazimi të dytë, zgjidhet kandidati i cili ka më shumë vjetërsi dhe është më me përvojë në proces. Eshtë detyrim i kandidatëve për të paraqitur dokumente që provojnë nivelin dhe përvojën e tyre.

## **Kapitulli II**

### **Përkufizimi i termave bazë dhe parimet**

#### **Neni 5**

#### **Përcaktimi i termave**

Në përputhje me këtë këtë kod, do të thotë që:

1. Përfaqësues të shoqërisë civile në MSG/Grupin shumë-palësh: mund të jetë çdo individ, anëtar i një organizate të shoqërisë civile që dëshiron dhe është i përfshirë në sektorin e burimeve natyrore i cili është propozuar nga kolegët për të përfaqësuar dhe për të mbrojtur opinionet e shoqërisë civile në MSG.

**Neni 6**  
**Parimet bazë**

1. Çdo përfaqësues i shoqërisë civile në MSG, zgjidhet nëpërmjet një procesi transparent dhe demokratik, ku përfshihen të gjitha organizatat që firmosin këtë Kod.

2. Mandati i përfaqësuesit të shoqërisë civile zgjat tre vjet, e rincovueshme vetëm një herë;

3. Çdo kandidat për postin e përfaqësuesit e shoqërisë civile në MSG, duhet së pari të përbushë kriteret si më poshtë:

- Të jetë anëtar që përfaqëson një organizatë të pavarur të shoqërisë civile që është aktive në fushën e burimeve natyrore;
- Të ketë të paktën tre vjet përvojë në fushën e mbrojtjes së transparencës në industrinë nxjerrëse, duke përfshirë edhe me institucionet e nivelit shtetëror dhe përfaqësues të sektorit privat;
- Të ketë njohuri të avancuara në EITI në veçanti;
- Të demostrojë pavarësi në lidhje me qeverine dhe kompanitë e industrisë nxjerrëse.
- Te tregojë prova të një shkalle të lartë të moralit, integritetit, respektimin e kolegëve të tyre.
- Nuk është i lidhur politikisht si individ apo organizatë.
- Nuk ka pozitë të lartë/drejtuese në administratën shtetërore, zyra publike apo kompani private që kane lidhje me industrinë nxjerrese dhe mbulohen nga procesi i EITI-t.
- Nuk duhet të lejojë asnjë ndërhyrje apo përfshirje të qeverisë në çështjet e Shoqërisë civile.
- Nuk duhet të ketë asnjë konflikt interesit as me qeverinë as me biznesin e industrisë nxjerrëse.

4. Të ketë angazhim të plotë për çështjet gjinore dhe të marrë masat e nevojshme për të garantuar përfaqësimin e grave në MSG;

5. Të sigurojë përfaqësimin e palëve të tjera nga zonat e prekura nga aktivitetet e industries nxjerrese dhe të marrë masat e nevojshme për të garantuar përfaqësimin e tyre në MSG.

**Kapitulli II**  
**Të drejtat, detyrat dhe detyrimet**

**Neni 7**  
**Të Drejtat**

Çdo anëtar, i mandatuar nga një organizatë e shoqërisë civile të aderuar në këtë kod, i cili përbush kërkjesat e përmendura më lart ka të drejtë për t'u emëruar si përfaqësues i shoqërisë civile në MSG.

Çdo përfaqësues ka të drejtë të shprehe mendimet e tij/saj, të marrin pjesë në diskutime dhe për të votuar në MSG.

### Neni 8

#### Detyrat

1. Të gjithë përfaqësuesit e shoqërisë civile në MSG duhet të konsultohen me mbështetësit e tyre (komunitetet lokale, rrjeteve të OJQ-të tjera, etj) dhe të raportojë rregullisht.
2. Të gjithë përfaqësuesit e shoqërisë civile në MSG, kanë për detyrë të përcjellin informacionin e duhur tek mbështetësit a tyre për të lejuar mundësinë e ndikimit të duhur në lidhje me vendimet e marra në përputhje me rregullat dhe procedurat që rregullojnë funksionimin e MSG.
3. Takime përgatitore duhen të koordinohen për të vodusur për qëndrimin e shoqërisë civile në ceshjet e rendit të ditës së MSG-së, ku çdo përfaqësues angazhohet për të mbështetur pozicionin e miratuar nga grupei e shoqërisë civile gjatë takimeve përgatitore, si dhe për interesat e përbashkëta.

### Neni 9

#### Detyrimet

1. Të gjithë përfaqësuesit kanë detyrimin që në mënyrë aktive të marrin pjesë në mbledhjet e MSG,
2. Të ngrihen për interesa që mbron dhe promovon shoqëria civile, transparenca, antikorrupsioni, qeverisja dhe kontrolli i publikut gjatë seancave të MSG.
3. Të gjithë përfaqësuesit kanë për detyrë të marrin pjesë në takimet përgatitore të cilat janë thirrur nga zëdhënësi/ja shoqërisë civile ose nga çdo përfaqësues, ku do të paraqiten pikat e rendit të ditës, të pozitës apo rekomandime së shoqërisë civile.
4. Nëse një anëtar voton kundër vendimit të marrë nga grupei, ai gjithsesi duhet të mbështesë vendimin e grupit gjatë mbledhjeve në MSG apo në publik.
5. Duhet të ketë një angazhim të fuqishëm për një qëndrim unik si grup.
6. Pakënaqësítë individuale apo personale nuk duhet të reflektohen në mbledhjet e MSG.

### Seksioni 2

#### Faktet dhe aktet e dënueshme

#### Neni 10

Në fund të këtij kodi, aktet që këtu konsiderohen si fakte të dënueshme, mund të sjellin humbjen e statusit si përfaqësues:

1. Çdo fakt apo akte, përfshirë fjalë, levizje të votave, email, shprehje, deklarata që kanë si qëllim final të prishin pozicionin e vendosur nga organizatat e shoqërisë civile pas debateve apo konsultimeve mes kolegëve;
2. Çdo akt korruzioni, i tillë si marrdhënie/ marrëveshje të fshehta personale, lidhur me autoritetet e EITI-t të cilat pengojne interesat dhe parimet e grupit të Shoqërisë civile, konsiderohet shkelje e hapur e këtij kodi.
3. Pranimi nga një përfaqësues i një dhurate që tejkalon vlerën 300 leke ose ndonjë tjeter avantazh nga një anëtar i një grupimi tjeter, apo çdo personi që punon në strukturat e EITI-t. Në rastin e fundit, ndonjë dhuratë që tejkalon vlerën e përmendur më lart duhet të deklarohet duke njoftuar me e-mail ose me një deklaratë të nënshkruar nga vete personi.
4. Bëjnë përashtim, vetëm të pagesave si kompensim (sipas ligjit shqiptar) për udhëtim, akomodim dhe dietat e arsyeshme nga Sekretariati EITI për anëtarët e shoqërisë civile që jetojnë jashtë kryeqytetit që duhet të janë të pranishëm në mbledhjet e MSG.
5. Në rast të një dyshimi që mund të perceptohet ose të jetë konflikt real interesit bazuar në rolin dhe përgjegjësitë e tyre, mund të kërkohet shpjegim ose hapje e të dhënave personale për përfaqësuesit e ShC-ve në MSG.
6. Anëtarët e grupit të OSCH-ve në MSG do të jetë përgjegjës për zbatimin e këtyre sanksioneve.

#### Neni 11

Pa cenuar/gjykuar dispozitat e nenit 6, pika 3, çdo përfaqësues i cili është shpallur fajtor apo bashkëfajtor me aktet e listuara më sipër do të humbasë statusin e tij si përfaqësues.

#### Sekcioni 3 Humbja e statusit, largimi dhe zëvendësimet

#### Neni 12

Humbja e Statusit të përfaqësuesve në MSG bëhet me:

1. Letër dorëheqje, ku njoftohet zëdhënësi, dezertim, revokimin, mungesa e pajustifikuar 3 herë në vazhdim në Mbledhjet e Grupit MSG, papajtueshmëria sipas nenit 2 pika 5, të këtij kodi, neglizhenca ose shkelja e dispozitave të këtij kodi, vdekja.

Përveç në rastet e shkaqeve të arsyeshme, përfaqësuesi i cili nuk ka marrë pjesë në 3 mbledhje të njëpasnjëshme Grupit ne MSG, mund të emërojë një tjeter anëtar të organizatës së tij për ta përfaqësuar atë për aq kohë sa ai/ajo do të mungojë.

2. Kur ndryshon statusin e tij; është emëruar në pozitë të lartë/drejtuese në administratën shtetërore apo zyra publike apo kompani private që kane lidhje me industrine nxjerese dhe që mbulohen nga procesi i EITI-t .

#### **Neni 13**

Humbja e statusit përfaqësues certifikohet nga anëtarët e Grupit të Shoqërisë Civile në MSG.

#### **Kapitulli IV: Komunikimi**

#### **Neni 14**

Funksioni i Zëdhënësit të grupit të shoqërisë civile në MSG vendoset brenda grupit.

Zëdhënësi emërohet nga përfaqësuesit e shoqërisë civile në mënyrë konsensuale të votave të përgjithshme shumicë (50% +1).

#### **Neni 15**

Zëdhënësi ka detyrimin për shperndarjen e informacionin organizatave të grupit, duke përfshirë ndarjen e dokumenteve të punës me e-mail ose ndonjë metodë tjeter që konsiderohet e efektshme.

#### **Kapitulli V Dispozita përfundimtare**

#### **Neni 16**

Zgjedhja e parë zhvillohet 3 vjet pas hyrjes në fuqi të këtij kodi dhe në përputhje me dispozitat në nenet 6, 7, 8, dhe 9.

Përfaqësuesit të cilët kanë përfunduar më shumë se 3 vjet do të zëvendësohen sipas rendit të zgjedhjes (i zgjedhuri i parë, largohet i pari).

#### **Neni 17**

Ish-përfaqësuesit e shoqërisë civile në Grupin e MSG, konsiderohen si grup mbështetje i cili duhet të ndihmojë (vullnetarisht) në çështje të ndryshme, duke përfshirë procesin e zgjedhjeve, etj.

Një person i cili ka patur mandatin e refuzuar nuk mund të jetë pjesë e grupit mbështetës.

#### **Neni 18**

Dispozitat e këtij kodi mund të janë subjekt i një rishikimi, me propozim me shkrim të dy të tretave të organizatave nënshkruese (të këtij kodit).

Tiranë prill 2015

Anila Hajnaj

Ilir Aliaj

Sami Nezaj

Madiina Puka

Baki Bajraktari